



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	06.06.2023	08.06.2023	2023/0348

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.06.2023, OE “GRANITI SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0348, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “GRANITI SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Kolonia e artisteve Faza II-inventar dhe paisje tjera” me nr. të prokurimit: "631-23-3039-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: xx,xxx €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0348 i dt:05.06.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Njoftimi per kontrate eshte bere me dt. 31.03.2023, ndërsa hapja e ofertave eshte bere me dt. 24.04.2023

Të nderuar ne me dt. 23.05.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e keni rekomanduar për kontratë **WOOD CORPORATION L.L.C.**, ndërsa neve na keni dërguar letër standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo- normalisht të ulët, mirëpo jo letër standarde për tenderues të eliminuar.

Fillimisht në lidhje me letrën standarde për informata mbi tenderët jo normalisht të ulët që ju na keni dërguar neve, ju sqarojmë se ne si kompani për shkak të një lëshimi teknik nga ana jonë nuk e kemi parë letrën standarde të cilën na keni dërguar dhe për këtë arsye nuk ju kemi kthyer përgjigje.

Ndërsa sa i përket njoftimit mbi vendimin të cilin e keni publikuar me dt.23.05.2023, ju sqarojmë se ju nuk keni vendosur ndonjë arsye të eliminimit mirëpo vetëm e keni publikuar letrën standarde për informata mbi tenderët jo normalisht të ulët.

Nëse e keni menduar si arsye të eliminimit faktin se nuk ju kemi kthyer përgjigje, ju sqarojmë se ky arsyetim nuk mund dhe nuk duhet të qëndroj dhe njëkohësisht e njëjta është e pa bazuar, për faktin se jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë me çmimet me të cilat kemi ofertuar.

Ndërsa se si ne kemi ardh në përfundim që të ofertojmë me çmimin me të cilin kemi ofertuar, së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim do të ju bashkangjesim dokumentin ku i kemi sqaruar çmimet për secilin pozicion, pra kemi dhënë sqarime detale për secilin nga pozicionet. **(Bashkangjitur gjeni sqarimin për çmimet me të cilat kemi ofertuar)**. Kete sqarim e kemi bashkangjitur edhe me kërkesë per rishqyrtim.

Gjithashtu ju sqarojmë se asnjëra nga çmimet me të cilat kemi ofertuar ne, nuk janë çmime manipulative, mirëpo janë të analizuara mirë nga ana jonë, ku edhe kemi ardhur në përfundim që të ofertojmë me këto çmime.

Andaj ne ju informojmë se qëndrojmë në tërësi pranë të gjitha çmimeve të dhëna në të gjitha pozicionet dhe ju garantojmë se ne jemi në gjendje të përmbushim këtë kontratë ashtu siç është kërkuar dhe ashtu siç kemi ofertuar me ato çmime.

Gjithashtu ne jemi në gjendje të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit aq sa ju e shihni të arsyeshme edhe 20% apo 30 %, si garancion se ne mund ta përfundojmë këtë projekt me kohë dhe në mënyrë profesionale me çmimet që ne i kemi ofruar.

Ne me dt. 31.05.2023 kemi pranuar vendimin per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta eshte e pa bazuar, mirëpo nuk ka ofruar fakte dhe prova konkrete per nje refuzim te tille. Në arsyetimin e cekur se ne nuk jemi përgjigjur brenda afatit te parashikuar per çmimet e ofruara nga ne.

Ky arsyetim nuk duhet te merret per baze sepse lëshimet teknike mund te ndodhin por qe ky lëshim nuk ndikon aspak ne procedure dhe ne aspektin material te këtij tenderi, prandaj sqarimet janë bere dhe bashkangjitur me kerkese per rishqyrtim dhe eshte dashur te merren parasysh nga autoriteti kontraktues.

Leshimi teknik konsiderohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii), prandaj kjo dispozite eshte dashur te merret parasysh dhe te analizohen sqarimet tona qe i kemi bere dhe bashkangjitur me kerkese per rishqyrtim.

Sidomos devijimet e vogla duhet te merren parasysh ne rastet kur çmimi eshte shume me i ulet, e ne kete rast çmimi i neve si OE ankues eshte shume me i ulet se sa i OE te rekomanduar per kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Siç shihet ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë. Ne kemi ofruar çmim **103,025.00€**, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej **129,358.00 €**. **Pra ne kemi ofertuar me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë në vlerë prej 26,333.00€.**

Kjo diference e çmimit eshte shume e madhe dhe te dëmtohet buxheti i Komunes ne kete vlere vetëm se nuk jemi përgjigjur ne afatin qe e ka dhene AK-ja (per nje devijim te vogël) eshte me te veret absurde.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues eshte dashur te kete në konsideratë edhe nenin 1 të LPPsë, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Dukeu bazuar ne faktet qe u përmend me larte, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe te shqyrtoj ankesën tone dhe te nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankese e OE: “Graniti Sh.p.k.”

ANULOHET, Njoftimi mbi vendimin B58 dhe lënda te kthehet ne

RIVLERESIM dhe gjate rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit per kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se.

Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues si dhe Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë te njejta me disa plotësim shtesë me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

Pretendimet e OE ankues nga ky aktivitet i prokurimit, kanë të bëjnë pasi nuk është përgjigjur në Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, të dërguar nga AK me datë 08.05.2023.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE: GRANITI SH.P.K. Rr. Ibrahim Rugova p.n. 23000, Shirokë, Suharekë, Gjate vlerësimit të tenderit komisioni i vlerësimit ka konstatuar se duke u bazuar në çmimin e ofertës në krahasim me vlerën e parashikuar të këtij projekti është 106,975.00 € me i ulët, ndërsa 26,333.25 € me i lire se tenderuesi tjetër me i lire. Andaj duke u bazuar në: UDHËZUES NR. 001/2023 PËR PROKURIM PUBLIK

11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët

11.1 Në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

1. Jane pranuar me shume se 3 oferta

2. Cmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

3. Cmimi i ofruar është me shume se 10% me i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Andaj është Jo-Normalisht i ulët për këto tender.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

////

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

////

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - GRANITI SH.P.K.

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin në këtë aktivitet të prokurimit të operatorit ekonomik ankues, se në lidhje me letrën standarde për informata mbi tenderët jo normalisht të ulët që ju na keni dërguar neve, ju sqarojmë se ne si kompani për shkak të një lëshimi teknik nga ana jonë nuk e kemi parë letrën standarde të cilën na keni dërguar dhe për këtë arsye nuk ju kemi kthyer përgjigje.

Ndërsa sa i përket njoftimit mbi vendimin të cilin e keni publikuar me dt.23.05.2023, ju sqarojmë se ju nuk keni vendosur ndonjë arsye të eliminimit mirëpo vetëm e keni publikuar letrën standarde për informata mbi tenderët jo normalisht të ulët.

Nëse e keni menduar si arsye të eliminimit faktin se nuk ju kemi kthyer përgjigje, ju sqarojmë se ky arsyetim nuk mund dhe nuk duhet të qëndroj dhe njëkohësisht e njëjta është e pa bazuar, për faktin se jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë me çmimet me të cilat kemi ofertuar.

Ndërsa se si ne kemi ardh në përfundim që të ofertojmë me çmimin me të cilin kemi ofertuar, së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim do të ju bashkangjesim dokumentin ku i kemi sqaruar çmimet

për secilin pozicion, pra kemi dhënë sqarime detale për secilin nga pozicionet. (**Bashkangjitur gjeni sqarimin për çmimet me të cilat kemi ofertuar**). Këtë sqarim e kemi bashkangjitur edhe me kërkesë për rishqyrtim.

Gjithashtu ju sqarojmë se asnjëra nga çmimet me të cilat kemi ofertuar ne, nuk janë çmime manipulative, mirëpo janë të analizuara mirë nga ana jonë, ku edhe kemi ardhur në përfundim që të ofertojmë me këto çmime.

Andaj ne ju informojmë se qëndrojmë në tërësi pranë të gjitha çmimeve të dhëna në të gjitha pozicionet dhe ju garantojmë se ne jemi në gjendje të përmbushim këtë kontratë ashtu siç është kërkuar dhe ashtu siç kemi ofertuar me ato çmime.

Gjithashtu ne jemi në gjendje të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit aq sa ju e shihni të arsyeshme edhe 20% apo 30 %, si garancion se ne mund ta përfundojmë këtë projekt me kohë dhe në mënyrë profesionale me çmimet që ne i kemi ofruar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, AK me datë: 08.05.2023 ora: 15:15 ka ngarkuar në letër standarde e kërkesë për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët për OE ankues, po citoj si në vijim:

OE: GRANITI SH.P.K. Rr. Ibrahim Rugova p.n. 23000, Shirokë, Suharekë, Gjate vlerësimit të tenderit komisioni i vlerësimit ka konstatuar se duke u bazuar në çmimin e ofertës në krahasim me vlerën e parashikuar të këtij projekti është 106,975.00 € me i ulët, ndërsa 26,333.25 € me i lirë se tenderuesi tjetër me i lirë. Andaj duke u bazuar në: UDHËZUES NR. 001/2023 PËR PROKURIM PUBLIK

11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët

11.1 Në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

1. Janë pranuar me shume se 3 oferta

2. Çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm.

3. Çmimi i ofruar është me shume se 10% me i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Andaj është Jo-Normalisht i ulët për këtë tender.

*Informatat e kërkuara duhet të pranohen **me shkrim** në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues, ose në numrin e fax-it [shëno numrin e faksit] apo në e-mail: prokurimi.decan@rks-gov.net brenda **5 ditëve** nga data e kësaj kërkesë. Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.*

Mirëpo, OE ankues ashtu siç e ka deklaruar edhe vet ne deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet se nuk përgjigjur po citoj: “*ju sqarojmë se ne si kompani për shkak të një lëshimi teknik nga ana jonë nuk e kemi parë letrën standarde të cilën na keni dërguar dhe për këtë arsye nuk ju kemi kthyer përgjigje*”, prandaj bazuar ne **nenin 41. 7 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimi Publik**, ku thotë: “*Operatori Ekonomik do ti përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet*”, dhe AK – komisioni i vlerësimit, ZPP kanë vepruar sipas këtij neni te Rregullores për Prokurim Publik, prandaj lidhur me këtë pretendimduke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm**.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **ka respektuar nenin 59 dhe 61 të LPP-së**, andaj, **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP**, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **refuzohet si e pa bazuara**(për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë), dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues që të mbete në fuqi vendimi i AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **GRANITI SH.P.K.**

Sahit Beqiri

